

## Partizani/ Priten te tjera perforcime nga Kosova ne janar

nga AlbaniaSoccer

E martë, 03 Dhjetor 2013 00:28

---



Partizani nuk heq dore nga merkato me lojtare nga Kosova. Duke pare qe skuadra ka bere mjaft mire me futbollistet e afruar ne vere dhe duke pare se per momentin te kuqte jane ne vendin e dyte te tabelës se klasifikimit, drejtuesit e Partizanit i kane hyre bisedimeve me disa futbolliste te tjere nga Kosova. Zhdrella, Rexha dhe disa lojtare te tjere jane piketuar dhe shume shpejt Partizani do tu bej nje oferte. Te kuqte kane me shume oreks tani per te qendruar ne nivele te larta duke pare se gjerat per skuadren kane shkuar mjaft mire. Janari pritet te sjelle disa perforcime nderkohe qe nuk do te mungojne as largimet e lojtareve qe nuk kane bindur.